


Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nën paragrafi 5.12 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, dhe në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.14 dhe 1.15 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOQSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 03.02.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

1. **Miratohet Plani i Punës i Bordit Drejtues për vitin 2026**, sipas dokumentit të bashkëngjitur këtij Vendimi (Aneks 1).
2. Plani nga pika 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi dhe zbatohet nga Bordi Drejtues, me mbështetjen e Administratës së OIRK-së, sipas përgjegjësiwe përkatëse.
3. Ky Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.



Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
5. **Nebi Pllana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së

PLANI I PUNËS I BORDIT DREJTUES PËR VITIN 2026

1. Qëllimi i Planit

Ky plan përcakton prioritetet dhe aktivitetet e Bordit Drejtues për vitin 2026, me synim:

- konsolidimin e funksionimit institucional të Odës,
- zbatimin e detyrimeve statutare dhe ligjore,
- rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj anëtarëve,
- transparencë dhe menaxhim të qëndrueshëm financiar,
- ngritje të standardeve profesionale përmes edukimit dhe rregullimit të brendshëm.

2. Aktivitetet kryesore të Bordit Drejtues për vitin 2026

A) Qeverisja dhe funksionimi institucional

1. Miratimi i Planit të Punës 2026 dhe përcaktimi i prioritetëve.
2. Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të Bordit Drejtues sipas planifikimit vjetor dhe trajtimi i vendimeve operative.
3. Koordinimi me Kryetarin dhe Administratën për zbatimin e vendimeve të Bordit dhe realizimin e aktiviteteve të Odës.
4. Përgatitja e Raportit vjetor të punës për vitin 2026, për paraqitje në Kuvendin vjetor të radhës.
5. Thirrja dhe organizimi i Kuvendit vjetor, së paku një herë në vit.
6. Formimi i grupeve punuese dhe/ose këshillave profesionale të ndryshme sipas nevojës, për trajtimin e çështjeve specifike profesionale, ligjore, teknike apo organizative.
7. Zbatimi dhe monitorimi i punës së grupeve punuese dhe/ose këshillave profesionale, të përcaktuara me vendime të veçanta gjatë vitit 2025, duke siguruar plan pune, takime, raporte periodike dhe rekomandime për Bordin Drejtues gjatë vitit 2026.

B) Administrata dhe shërbimet për anëtarët

8. Funksionalizimi i plotë i Administratës
9. Përmirësimi i shërbimeve administrative për anëtarët.
10. Platformë e komunikimit me anëtarët (njoftime periodike, njoftime zyrtare për vendime dhe aktivitete).
11. Përmirësimi i Webfaqes së Odës dhe publikimi i informatave të rëndësishme për anëtarët dhe publikun, përfshirë aktet dhe informacionet institucionale.

C) Menaxhimi financiar dhe kontrolli i shpenzimeve

12. Monitorimi i ekzekutimit të financave (grantit qeveritar) sipas planifikimit.
13. Hartimi dhe miratimi i "Rregullores për procedurat e shpenzimeve / prokurimit" (blerje, shërbime, pagesa, udhëtime, kontraktime), për të siguruar transparencë dhe kontroll.
14. Raportim periodik financiar për Bordin dhe Komisionin Mbikqyrës, me listë të shpenzimeve, të hyrave dhe angazhimeve.

15. Bashkëpunim me Komisionin Mbikëqyrës, për kontroll të ligjshmërisë dhe mbikëqyrje financiare.
16. Planifikim i qëndrueshmërisë financiare për kalimin gradual drejt vetë-financimit të plotë (tarifa, shërbime, aktivitete profesionale).
- 16.1. Analizë financiare për vetë-financim të Odës, duke hartuar skenarë të qartë për të hyrat vetanake (tarifa anëtarësie, licencim/rilicencim, shërbime profesionale, edukim profesional), dhe plan të fazuar për zvogëlim gradual të varësisë nga grantet.

D) Licencimi, rilicencimi dhe standardet profesionale

17. Funksionimi i rregullt i procesit të licencimit/rilicencimit, me afate dhe transparencë për aplikimet.
18. Evidentimi dhe raportimi i statistikave për licenca/rilicenca (numër aplikimesh, aprovime, refuzime, arsyetime).

E) Edukimi i vazhdueshëm profesional (EVP)

19. Zbatimi i Programit të edukimit të vazhdueshëm profesional sipas programit të miratuar.
20. Organizimi i trajnimeve/ligjëratave profesionale gjatë vitit 2026, me temat prioritare për fushën e ndërtimit.
- 20.1. Bashkëpunim me universitetet dhe fakultetet për organizimin e Panairit të Tregut të Punës (1 herë në vit), ku marrin pjesë kompani projektimi, kompani ndërtimi dhe operatorë të tregut në fushën e shërbimeve të ndërtimit; me qëllim orientimin e studentëve dhe lidhjen e tyre me tregun real të punës në Kosovë.

F) Etika, disiplinë dhe trajtimi i ankesave

21. Zbatimi i Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale në praktikë (informim i anëtarëve dhe trajtim i rasteve kur ka shkelje).
22. Mbështetja e Komisionit Disiplinor dhe Komisionit të Ankesave në funksionim procedural dhe administrativ, sipas rregulloreve.
23. Raportim i përgjithshëm vjetor për disiplinën (pa cenim të të dhënave personale), në funksion të transparencës dhe parandalimit.

G) Sigurimi i përgjegjësisë profesionale

24. Zbatimi i rregullores për sigurimin e përgjegjësisë profesionale (informim, afate, monitorim, zbatim në rilicencim).
25. Marrëveshje bashkëpunimi me kompani sigurimi, për kushte më të favorshme për anëtarët (nëse vlerësohet e arsyeshme).

H) Partneritete dhe ndikim publik

26. Bashkëpunim institucional me Ministrinë, Komunitat dhe Universitetet, për avancim të standardeve dhe mbrojtje të profesionit.

27. Bashkëpunim me organizata profesionale vendore dhe ndërkombëtare, për shkëmbim përvojash dhe njohje të praktikave të mira.
28. Avokim për çështjet e inxhinierëve (paga, trajtimi në prokurim, pozita profesionale, standardet e punës) përmes qëndrimeve dhe rekomandimeve.
- 28.1. Në Memorandumet e Bashkëpunimit me institucionet publike, të **përfshihet edhe “Cmimorja minimale referuese” si dokument orientues**, me qëllim standardizimin e praktikës dhe referimin e saj në bashkëpunime institucionale.

I) Aktivitetet tradicionale

29. Organizimi i Ditës Botërore të Inxhinierëve – 4 Mars, si ngjarje vjetore e Odës (me program, panele, mirënjohje).

J) Grupe punuese dhe dokumente/akte profesionale (zbatim i vendimeve të Bordit 2025)

30. **Kategoria 2.4 – Përmbajtja e dokumentacionit teknik të projektimit (doracak):** Hartimi i një dokumenti (doracaku) për standardizimin e përmbajtjes së dokumentacionit teknik të projektimit, në funksion të unifikimit të praktikave profesionale dhe rritjes së cilësisë së dokumenteve.
31. **Sipas nevojës së Bordit Drejtues, do të trajtohen edhe:**

Kategoria 2.2 – Amendamenti i bazës normative të Odës: Hartimi i propozimeve për amendamentim (Ligji nr. 08/L-012, UA MMPHI nr.06/2023, Statuti, Kodi i Etikës dhe rregulloret ekzistuese), si dhe hartimi i rregulloreve të reja të OIRK-së kur vlerësohet e nevojshme.

Kategoria 2.3 – Amendamenti i legjislacionit sektorial: Hartimi i propozimeve për amendamentim të Ligjit të Ndërtimit dhe Ligjit të Planifikimit Hapësinor.

31.1. **Shqyrtimi dhe analiza periodike e Ligjit, Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve të OIRK-së,** me qëllim identifikimin e boshllëqeve, nevojës për përditësim, harmonizim dhe rritje të zbatueshmërisë praktike.

31.2. OIRK në bashkëpunim me OARK të vazhdojë punën në dokumentin e “**Cmimore Minimal Referuese**”, si standard profesional orientues për tregun dhe institucionet.

K) Bashkëpunimi institucional, memorandumet dhe integrimi rajonal/evropian

32. Organizimi i takimeve të rregullta me institucionet relevante për zbatimin e ligjit dhe avancimin e rolit të Odës (Ministritë, Komunat, Inspektoratet, institucionet publike dhe autoritetet përgjegjëse).
33. Bashkëpunim aktiv me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim ngritjen e standardeve profesionale, mbrojtjen e interesit të anëtarëve dhe fuqizimin e rolit të inxhinierit në shoqëri.

34. Hartimi dhe nënshkrimi i Memorandumeve të Bashkëpunimit (MoU) me institucione publike, universitete, organizata profesionale dhe partnerë strategjikë, sipas nevojës dhe interesit të Odës.
35. Bashkëpunimi me odat rajonale homologe të inxhinierëve, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe harmonizimin e praktikave profesionale.
36. Organizimi i vizitave zyrtare rajonale dhe ndërkombëtare, pjesëmarrja në konferenca, trajnime dhe aktivitete profesionale, për prezantimin dhe fuqizimin e Odës.
37. Inicimi i procedurave dhe përgatitja e dokumentacionit për aplikim për anëtarësim në organizata evropiane të inxhinierëve, përfshirë **ECEC (European Council of Engineers Chambers)** dhe të ngjashme, në përputhje me kriteret dhe interesin institucional të Odës.

Prishtinë, 27.01.2026

Bordi Drejtues i OIRK-së

Arsim Rapuca

Kryetar

(Nënshkrimi dhe vula)

